

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ilir Meta në Apelin e Posaçëm: Kam qenë në çdo seancë, pse të më pezullohen afatet e paraburgimit?
ADRESA	https://www.gazetatema.net/kronika/ilir-meta-ne-apelin-e-posacem-kam-qene-ne-cdo-seance-pse-te-me-pezullohe-i586503
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	16 shtator 2026, 13:54:10 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	16 shtator 2026, 13:50:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0a5de10321a65a383115e6528e061bbbc5ce8a1f6aac01f57bbbe1fd2a991363
TEKSTI	04b8b5b4075394b9744082179c38040c2979733e1bd8477a19cbdb4d65cea737
PAMJA	168a569ef41a4c54ccf9d5b349bbb5f7c5bef0f53b2308085570f5244a4e32f4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	fc91d5eecb26e830705dc1ca59e9c2821a6d142e0167fa1bfa9a2557270041e6
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	485c8b8c8ba28305218c58e8c7791d525f1a193166e89422b0670a53018cd566
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/fc91d5eecb26e830705dc1ca59e9c2821a6d142e0167fa1bfa9a2557270041e6>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

English

Built and Monetized by [Kontakt](#)



English




1 e Ilir Meta në Apelin e Posaçëm: Kam qenë në çdo seancë, pse të më pezullohen afatet e paraburgimit? Sally Field fiton Emmy-n e katërt në moshën /9-vjeçareDenimi me 8 fundit

Ilir Meta në Apelin e Posaçëm: Kam qenë në çdo seancë, pse të më pezullohen afatet e paraburgimit?



16 Shtator 2026, 15:50Kronika TEMA



Është mbajtur seanca në Gjykatën e Apelit të Posaçëm, me relatore gjyqtare e posaçme Saida Dollani, një proces ku ish-presidenti kundërshton pezullimin e afateve të paraburgimit.

Ndryshe nga seancën e mëparshme, gjyqtarja kishte vendosur nxjerrjen nga kafazi të Metës, Metën e sollën sërish në kafaz.

Avokati i tij, siç raporton Anila Hoxha, raporton se avokati kërkoi sërish nxjerrjen nga kafazi të Metës dhe gjykata urdhëroi që Meta të dalë nga kafazi dhe të ulët me avokatin në krah.

Avokati i Metës: Sipas kërkesës tonë, me objekt kundërshtimin e pezullimit të afateve të paraburgimit, rrethanat e faktit janë:

Referuar vendimit unifikues, pretendojmë se lejohet ankimi veçmas dhe, sipas jurisprudencës së Kushtetueses, gjykata e shkallës së parë (GJKKO) ka cenuar të drejtën time dhe standardet.

Meta: I qëndroj tërësisht ankimit që sapo lexoi avokati.

Prokurori i SPAK: Nga ajo që lexoi avokati, ai kërkoi pavlefshmëri ose, më saktë, është një vendim i ndërmjetëm. Në rastin konkret, ky vendim është marrë më 27 prill, ndërsa ankimi është bërë në korrik. Ndaj mendojmë që ky ankim nuk duhet pranuar. Në lidhje me thelbin e vendimmarrjes së GJKKO-së, është i bazuar në ligj, sepse gjykata vendosi mbi bazën e kërkesës sonë, për shkak se gjykimi në atë kohë ishte gjykimi ndaj 5 të pandehurve dhe jo si sot që po bëhet i ndarë. Në atë kohë, avokatja e Fatime Kryemadhit nuk ka pasur prokurë për tagrat që i ka dhënë klientja. Për këtë rrethanë, ne kërkuam që avokatja Esmeralda Ndrejoni të saktësojë aktet e përfaqësimit për klienten Fatime Kryemadhi. Ndaj, për këtë arsye shkaktare u bë mbrojtja, sepse shtyrja u bë për shkak të pasigurisë dhe lëndës rezultim të afateve të paraburgimit në Metën

paarsyetur dhe kërkuar pezullim të afatit të paraburgimit për metën.

Avokati i Metës: I qëndrojmë përsëri ankimit dhe nuk jemi dakord me prokurorin.

Gjykata: Ju urdhrin e gjykatës e ankimoni në formë apo në thelb?

Avokati: Ne mendojmë që duhet të jetë vendim dhe jo urdhër, dhe pasoja e këtij vendimi duhet të jetë i arsyetuar, se ndryshe unë s'kam si e ankimoj kur nuk është i arsyetuar. Vetëm kjo vendimmarrje është e paarsyetuar dhe, duke qenë i paarsyetuar, si ta ankimoja? Ne paraqitëm ankim brenda afatit ligjor.

Meta: Faleminderit, zonja gjyqtare. Dua të theksoj se në asnjë rast unë nuk kam munguar në asnjë seancë gjykimi, jo vetëm të gjykimit paraprak, por edhe të themelit, por edhe në çështje të tjera. Ndoshta ju ju kujtohet se kur e kam ditur që avokati im s'mund të merrte pjesë, unë jam paraqitur në seancë dhe kam kërkuar që gjyqi të vazhdojë pa avokatin. Dhe në këtë rast që ne e ngremë këtë pretendim, dua të theksoj se qëndrimi im atëherë ka qenë të vazhdojë seanca, por mbi të gjitha, ata persona në liri dhe më është dukur dhe vlerësoj që është e padrejtë se kur unë marr pjesë në gjyq, mua të më pezullohen afatet e paraburgimit. Sepse kjo nuk është aspak për shkak tim dhe as në interesin tim. Kjo është gjithmonë në interes të prokurorëve të çështjes dhe ky nuk është, është i vetmi rast.

Meta: Ka nisur nga 29 gushti, kur dorëzuan çështjen për gjykim, interesi është të më pezullojnë afatet e paraburgimit. Unë gjithmonë kam qenë në gjyq dhe kam kërkuar që gjyqi të zhvillohet. Faleminderit.

Prokurori Sotir Kllapi: Praktika është e konsoliduar, mjafton që të mungojë njëri nga avokatët dhe pezullohen për të gjithë.

Kllapi: Kërkesa që bën avokati për kthim të çështjes së afatit të pezullimit të paraburgimit me një tjetër trupë është e pamundur. Ne mendojmë që kjo gjykatë nuk mund ta prishë atë vendim të asaj date.

Avokati: Të mos bëjmë kundërreplikë, zonja gjyqtare. Ne kërkojmë pranimin e ankimit.

Gjykata: Vendimi do të shpallet ditën e nesërme, më datën 17 shtator, ora 14:00.

Top Channel

Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

[Ina Rama në trupën që gjykon mandatin e Ols Dados, prokurorin që vetë ia propozoi Presidentit Topi?](#)

15:00 Kronika / 9 komente

[Emërimi i prokurorit Ols Dado përfundon në Apelin Administrativ, hidhet shorti për ankimin e Veliajt](#)

11:10 Kronika / 29 komente

[Po transportonte 6 shtetas të huaj drejt Tiranës, arrestohet 23-vjeçari në Korçë](#)

10:20 Kronika



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.